Objekti i Shitjes: “Shitja e Automjetit Fiat Ducato , me targë VL 8480 C, i dalë jashtë përdorimit, në pronësi të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë”.

Data e zhvillimit të ankandit: 06.04.2021, ora 11:00

Procedura e ankandit: NR.REF. 1-A/2021

Publikime të mëparshme: S’ka Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatese të ofruara:

1. Orgest Muçaj Emri i ofetuesit ID.Nr.031802612

Vlera 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: S’ka

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin Orgest Muçaj ID.Nr.031802612 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 39, pika 5 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.04.2021. Ankesa: S’ka

BASHKIA CËRRIK
NOFTIMI FITUESIT ANKANDIT

1. I.Autoriteti shites: BASHKIA CËRRIK(adresa, nr. tel): Qyteti Cërrik
tel.058122263,bashkiacerrik@yahoo.com)
- 2.Data e zhvillimit të ankandit: 09.04.2021 ora 10.00
- 3.Proçedura e ankandit: (Proçedurë e hapur)
- 4.Objekti ankandit: “Për dhënie në përdorimtë sipërfaqes pyjore/kullosore”
- 5.Vlera fillestare pa T.V.SH. sipas loteve ishte:
Loti I. 107 000 (njëqind e shtatë mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti II. 190 000 (njëqind e nëntëdhjet mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti III. 35 000 (tridhjet e pesë mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti IV. 35 000 (tridhjet e pesë mijë)lekë/vit pa tvsh.
Loti V. 10 000(dhjetë mijë)lekë/vit pa tvsh.
- 6.Vlera e shpallur fituese pa T.v.sh. është:
Loti I. 107 000 (njëqind e shtatë mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti II. 190 000 (njëqind e nëntëdhjet mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti III. 35 000 (tridhjet e pesë mijë) lekë/vit pa tvsh.
Loti IV. 35 000 (tridhjet e pesë mijë)lekë/vit pa tvsh.
Loti V. 10 000(dhjetë mijë)lekë/vit pa tvsh.
- Ofertuesi i shpallur fitues sipas loteve është:
1.Për lotin I dhe II: Subjekti “Bullari Natyral Farm”shpk me nr. Nipti L42818201P me adresë: Elbasan Cërrik(lagjia Malasej).
2.Për lotin III dhe IV: Subjekti : Marjo Kumria me adresë Banjë e Re, Cërrik.
3.Për lotin V: Subjekti : Arben Shabani me adresë Qyrkan, Cërrik.
- 7.Ofertues të skualifikuar: Nuk ka.
- 8.Ofertuesët e shpallur fitues ftohen të paraqesin pranë Bashkisë Cërrik (Sektori i Pyjeve dhe Kullovave) kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat standarte të ankandit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga shpallja në Buletimin e Njoftimeve Publike. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorezuar me një vlerë prej (nuk ka ofertues të dytë), siç parashikohet në nenin 39 të ligjit për prokurimet publike nr. 9874 datë 14.02.2008, i ndryshuar.
Njoftimi i klasifikimit të fituesit është bërë më datë 09.04.2021

KONTRATA TË LIDHURA ANKANDI

ANULLIME ANKANDI

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANULLIM ANKANDI

Autoriteti Shitës, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), njofton se në ankandin e caktuar për tu zhvilluar në datë 10.11.2020, ora 11.00, me objekt “*Shitje e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike*”, 43.162 (dyzet e tremijë njëqind gjashtëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh, sipas Njoftimit të Ankandit, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, Nr. 89, datë 19.10.2020, nuk u paraqit asnjë ofertues.

Sipas Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, dhe parashikimeve të pikës 6/a të VKM Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit pubik” i ndryshuar, që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, me përzgjedhje të blerësve duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti shitës ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re.

Sa më sipër, APP vendosi anullimin e procedurës së ankandit, me objekt: “*Shitje e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike*”. Kjo procedurë do të rishpallet nga APP.

TË TJERA ANKANDE

KREU I KATËRT

Buletini i

ofertave të qirave

BASHKIA VAU DEJES**Formulari i Njoftimit të Fituesit të Konkurimit publik**

Autoriteti i Dhënies me qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurimin publik të zhvilluar me datën 12.04.2021, ora 13.⁰⁰, publikimi i të cilit është bërë me datën 29.03.2021 në buletin e njoftimeve publike nr.45 me objekt dhenie me qira:

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit Pyjor/kullosor publik sipas udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave Për Dhënie Në Përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kullosor Publik”: që i përket ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kire, ngastra nr.14 me sipërfaqe prej 0.747 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike, kampingje etj”, me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite.

2. Vlera fillestare:

Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 45,000 lekë, në vit dhe për sipërfaqen 0.747 ha është 33,615 lekë në vit në sipërfaqe cungishte, shkurre e përllëgaritur kjo sipas VKM nr. 1064, datë 22.10.2010, lidhja 2.pika 5/5 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Njoftojme se, ka qenë pjesëmarrës në procedure ky ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Subjekti “ F- Palushaj”sh.p.k numri i NIPT-it L17206005K

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kirw, ngastra nr. 14, në sipërfaqe prej 0.747 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike, kampingje etj” me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite, është 33,615 (tridhjetë e tremije e gjashtëqindë pesëmbëdhjetë) lekë në vit pa TVSH.

(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. S’ka të skualifikuar

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

1. Subjektin “ F- Palushaj”sh.p.k

Adresa: Stajka, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, se oferta e paraqitur për ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kirë, ngastra nr. nr.14 me sipërfaqe prej 0.747 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike, kampingje etj”, me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite, prej 33,615 (tridhjetë e tremije e gjashtëqindë pesëmbëdhjetë) lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë *Bashkise Vau Dejes*, me Adrese Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe reference kontakti zyrën e Drejtorisë së Zhvillimit Rural dhe Turizmit, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.04.2021.

Ankesa , S'ka

KONCESIONE / PARTNERITET **PUBLIK PRIVAT**

PROCEDURA KONKURRUESE PËR **LEJE MINERARE**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **FTESE PËR OFERTË**

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 5 pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 36/1 të Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, pikës 6 dhe 7, 9 (b, c), të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 02.05.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 29.4.2011 "Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.726, datë 02.09.2015 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar 2016 – 2018, i ndryshuar, VKM Nr. 664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019 – 2021, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, dhe Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 04.12.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2019”, shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese Nr. 420, Nr. 686/1.

2. Kërkohet që të realizohet aplikimi për leje minerare për zonat minerare konkurruese Nr. 420, Nr. 686/1, të miratuara në planet vjetore të viteve 2011 dhe 2019, me të dhënat dhe formën e formularit të ofertës të paraqitura në aneksin 1 të kësaj Ftese për Ofertë.

3. Kërkesat për kualifikim dhe kriteret e konkurrimit dhe vlerësimit të ofertave për të drejtën e aplikimit për një leje minerare në zonat konkurruese jepen në përputhje me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 02.05.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 29.4.2011 "Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.726, datë 02.09.2015 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar 2016 – 2018, i ndryshuar, VKM Nr.664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019 – 2021, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, dhe Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 04.12.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2019”.

4. Ofertuesit të paraqesin vetëm një Ofertë për një zonë konkurruese, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i

procedurës konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.

5. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuar, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të dërgohen tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në adresën: Rr. “Abdi Toptani”, Nr. 1, Tiranë.

6. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.

7. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është:

Për zonat: Nr. 420, Nr. 686/1;

dt. 27.05.2021, ora 10⁰⁰

8. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

9. Ofertat do të hapen në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Sallën e Mbledhjeve, Kati i parë,

Për zonat: Nr. 420, Nr. 686/1;

dt. 27.05.2021, ora 10⁰⁰

10. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

NJOFTIME TË TJERA

BANKA E SHQIPËRISË **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje pajisje ‘Armë elektroskok’ për nevojat e Bankës së Shqipërisë”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,194,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit, mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje pajisje ‘Armë elektroskok’ për nevojat e Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, Kompleksi “Halili”, deri më datë 17 Maj 2021, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

TËATRI KOMBËTAR **Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të ”Urdhëri i Kryeministrit Nr.108, dt.30.07.2015 për “Miratimin e Strukturës dhe Organizimit të Teatrit Kombëtar, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 dt. 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në administratën publike”, të nenit 20, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Teatrit Kombëtar, shpall konkurrimin për 1 (nje) vënd të lirë, në pozicionin:

Drejtor i Prodhimit

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, si njohës i mirë i ligjeve në fushën e marketingut dhe kërkesat e veçanta si më poshtë :

Kërkesa te veçanta per kandidatet

- ✚ Të ketë Diplomë Universitare Administrim/ Menaxhim Biznesi, Universitetin e Arteve/ Dega Skenografi, Pikturë & Skulpturë, Regjisorë, Arkitekturë (Arkitekt Skene).
- ✚ Të ketë përvojë pune mbi 3 vjet në menaxhimin e produksioneve teatrale.
- ✚ Të ketë njohuri bazë të programeve kompjuterike.
- ✚ Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- ✚ Të ketë aftësi të mira komunikimi, si dhe për të punuar në grup,
- ✚ Të ketë njohuri në një gjuhë të komunitetit europian.

Paga e pozicionit: është në kategorinë III-a (80.800 lekë +1%) të pagës së grupit për çdo vit vjetërsie).

Paraqitja e dokumentave:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur
- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara
- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit
- Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave apo çertifikatave.
- Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

Aplikimi fillon në datë 27.04.2021 dhe përfundon më datë 17.05.2021 ora 14.00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit.

Aplikanti do të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë adresën; Teatri Kombëtar, Rr.”Sami Frashëri” (ArTurbina) Tiranë” cel. 042 22 89 33, (në sekretarinë e T.K) këto dokumenta:

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të Web-it të Teatrit Kombëtar www.teatrikombetar.gov.al

TËATRI KOMBËTAR

Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të "Urdhëri i Kryeministrit Nr.108, dt.30.07.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organizimit të Teatrit Kombëtar, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 dt. 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003 " Për rregullat e etikës në administratën publike", të nenit 20, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Teatrit Kombëtar, shpall konkurrimin për 1 (nje) vend të lirë, në pozicionin:

Specialist Marketingu

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, si njohës i mirë në fushën e marketingut dhe kërkesat e veçanta si më poshtë :

Kërkesa të veçanta për kandidatet

-  Të ketë Diplomë Universitare në Degën Menaxhim Biznes/ Ekonomik/ Marketing/ Menaxhim Arti.
-  Të ketë përvojë pune mbi 3 vjet në marketing
-  Të jetë domosdoshmërisht njohës i mirë i gjuhës angleze, por dhe e gjuhëve të tjera.
-  Të ketë njohuri të mira kompjuterike.
-  Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
-  Të ketë aftësi të mira komunikimi, si dhe për të punuar në grup.

Paga e pozicionit: është në kategorinë IV-a (49.000 lekë +2%) të pagës së grupit për çdo vit vjetërsie).

Paraqitja e dokumentave:

Aplikimi fillon në datë 27.04.2021 dhe përfundon më datë 17.05.2021 ora 14.00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit.

Aplikanti do të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë në adresën; Teatri Kombëtar, Rr."Sami Frashëri" Skena e Re ArTurbina, Tiranë" tel. 042 22 89 33 në sekretarinë e T.K, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur
- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara
- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit
- Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave apo certifikatave.
- Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Web-it të Teatrit Kombëtar www.teatrikombetar.gov.al

TËATRI KOMBËTAR **Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të "Urdhëri i Kryeministrit Nr.108, dt.30.07.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organizimit të Teatrit Kombëtar, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 dt. 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003 " Për rregullat e etikës në administratën publike", të nenit 20, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Teatrit Kombëtar, shpall konkurrimin për 1 (nje) vënd të lirë, në pozicionin:

Mjeshtër i Skenës

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, si njohës i mirë i ligjeve në fushën e marketingut dhe kërkesat e veçanta si më poshtë :

Kërkesa te veçanta per kandidatet

- Të ketë arsimin e mesëm profesional mekanik, apo të tjera brenda fushës së mekanikës.
- Të ketë përvojë pune mbi mbi 3 vjet si saldator, hidraulik dhe teknik mirëmbajtje të pajisjeve të skenës.
- Të ketë njohuri shumë të mira të vizatimit teknik, zbërthimin në detaje të vizatimeve.
- Të njohë makineritë dhe mjete të tjera që kanë të bëjnë me realizimin e dekorit me konstrukcion metalik, të njohë edhe materialet që kanë të bëjnë me drurin, etj.
- Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, si dhe i aftë për të punuar në grup.

Paga e pozicionit: është në kategorinë IX, (39 800 lekë +1%) të pagës së grupit për çdo vit vjetërsie).

Paraqitja e dokumentave:

Aplikimi fillon në datë 27.04.2021 dhe përfundon më datë 17.05.2021 ora 14.00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit.

Aplikanti do të dorzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë adresën; Teatri Kombëtar, Rr."Sami Frashëri" (ArTurbina) Tiranë" cel. 042 22 89 33, (në sekretarinë e T.K) këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur
- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara

- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit.
- Dokumentat duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të Web-it të Teatrit Kombëtar www.teatrikombetar.gov.al

TËATRI KOMBËTAR

Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të "Urdhëri i Kryeministrit Nr.108, dt.30.07.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organizimit të Teatrit Kombëtar, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 dt. 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003 " Për rregullat e etikës në administratën publike", të nenit 20, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Teatrit Kombëtar, shpall konkurrimin për 1 (nje) vënd të lirë, në pozicionin:

Mjeshtër Parukier & Grimier

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, si njohës i mirë i ligjeve në fushën e dekorit të skenës dhe kërkesat e veçanta si më poshtë :

Kërkesa të veçanta për kandidatët

- ✚ Të ketë kryer arsimin e mesëm ose të lartë dega pikturë ose kurse apo shkollë për make-up art & parukeri, të vërtetuara me diplomën përkatëse.
- ✚ Të ketë përvojë pune mbi mbi 3 vjet si make-up art & parukere
- ✚ Të ketë njohuri mbi e skenës, të dijë të krijojë figura të spikatura artistike.
- ✚ Të jetë i aftë të përpunojë skica dhe bocete për karakteret e ndryshme të shfaqjes artistike
- ✚ Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- ✚ Të ketë aftësi të mira komunikimi, si dhe për të punuar në grup.

Paga e pozicionit: është në kategorinë IX, (39 800 lekë +1%) të pagës së grupit për çdo vit vjetërsie).

Paraqitja e dokumentave:

Aplikimi fillon në datë 27.04.2021 dhe përfundon më datë 21.05.2021 ora 14.00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit. Aplikanti do të dorzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë adresën; Teatri Kombëtar, Rr."Sami Frashëri" (ArTurbina) Tiranë" cel. 042 22 89 33, (në sekretarinë e T.K) këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur

- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara
- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit
- Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit, duhet të kenë bërë njohjen e diplomave apo certifikatave.
- Dokumentat duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të Web-it të Teatrit Kombëtar www.teatrikombetar.gov.al

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

NJOFTIM

Në zbatim të pikës 1 të nenit 52 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, të VKM-së nr.712, datë 31.07.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore”, i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit nr. 250, datë 7.6.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit të kërkesave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit nr. 4, datë 14.5.2019 “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, për procedurën e konkurrimit publik”, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpall pjesëmarrjen në konkurrim publik për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në zonat e mëposhtme ujore:

Data e konkurrimit 13. 05. 2021, ora 10.00

Nr.	Rrethi	Objekti ujor	Lloji i aktivitetit
1	Berat	Ujëmbledhësi/Pellgu i Samaticës (Nr. Pasurisë 342)	<i>Ripopullim & Peshkim</i>

2	Pogradec	Ujëmbledhësi Stropckë e Vjetër(Dardhas)	Ripopullim & Peshkim
3	Tiranë	Ujëmbledhësi i Stërmasit, Petrelë	Ripopullim & Peshkim
4	Tiranë	Ujëmbledhësi i Tapizës Nr.2 (i Qinamit,Zall Herr)	Ripopullim & Peshkim
5	Mirditë	Ujëmbledhësi Ndër-Fan	Ripopullim & Peshkim
6	Elbasan	Ujëmbledhësi i Çërragës(zona kënetore)	Ripopullim & Peshkim
7	Shkodër	Ujëmbledhësi Bardhaj	Ripopullim & Peshkim
8	Durrës	Ujëmbledhësi i Shkallës(Manëz)	Ripopullim & Peshkim
9	Durres	Ujëmbledhësi Radë 2	Ripopullim & Peshkim
10	Lezhe	Gjiri Shengjinit(i baraslargur nga grykederdhja e Drinit Vjeter dhe grykederdhja e lagunes se Merxhanit)	Peshkim artizanal me stavnik
11	Pukë	Ujëmbledhësi i Iballës	Ripopullim & Peshkim
12	Tepelenë	Ujëmbledhësi Krahës 1 Memaliaj	Ripopullim & Peshkim
13	Tepelenë	Ujëmbledhësi Krahës 2 Memaliaj	Ripopullim & Peshkim
14	Tepelenë	Ujëmbledhësi i Levanit Memaliaj	Ripopullim & Peshkim
15	Fier	Ujëmbledhësi i Turbullit(Cakranit)	Ripopullim & Peshkim
16	Fier	Ujëmbledhësi Cervenit, Kurjan, Roskovec	Ripopullim & Peshkim
17	Fier	Ujëmbledhësi i Zharrzës, Patos	Ripopullim & Peshkim
18	Mallakastër	Ujëmbledhësi i Greshicës	Ripopullim & Peshkim
19	Gjirokastër	Ujëmbledhësi Qesarat 1 - 9.7 Ha	Ripopullim & Peshkim
20	Gjirokastër	Ujëmbledhësi i Blanjes Qesaratit 2.7 Ha	Ripopullim & Peshkim
21	Gjirokastër	Ujëmbledhësi i Gjatit	Ripopullim & Peshkim

ANEKSI 1. Modeli standard i hartimit të plan biznesit

A. PJESA PËRSHKRUESE E PLANIT TË BIZNESIT

1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1 Aktiviteti tregtar, nëse ka.

1.2 Lloji i shoqërisë tregtare.

1.3 Përshkrim i burimeve të financimit.

1.4 Niveli i punësimit.

1.5 Performanca e aktivitetit nëse ka për tri vitet e fundit, si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë.....

2. PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT

2.1 Paraqitni me një përshkrim të shkurtër e të përgjithshëm të shprehjes së interesit

.....

2.2 Analiza e tregut të peshkut.

.....

2.3 A keni kontrata ekzistuese të ngjashme ose eksperiencë?

.....

2.4 Niveli i punësimit dhe aftësitë e nevojshme.

.....

2.5 Legjislacioni i zbatueshëm për këtë investim/aktivitet peshkimi/akuakulture.

.....

2.6 Përshkrim i riskut të këtij investimi/aktiviteti.

.....

3. PROJEKTI TEKNIK I INVESTIMIT TË PROPOZUAR

3.1 Teknologjia, procesi i prodhimit të propozuar dhe niveli i zënies/prodhimit peshkut.

.....

3.2 Ndërtim/rikonstruksioni, nëse ka.

.....

3.3 Pajisjet e nevojshme.

.....

4. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTI TË RI TË PROPOZUAR

4.1 Përmbledhje e kostove dhe financimit.

.....

4.2 Komente për parashikimet e të ardhurave dhe fitimit.

.....

B. UDHËZIM MBI PLOTËSIMIN E PJESËS PËRSHKRUESE TË PLANIT TË BIZNESIT

1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1 Aktiviteti tregtar aktual i aplikantit.

- Përshkruani shkurtimisht aktivitetin ekzistues, përfshirë tregun e produktit peshkor dhe përcaktoni konsumatorët tuaj kryesorë.

- Përshkruani kontratat ekzistuese me blerësit.

- Përshkruani konkurrentët tuaj kryesorë dhe pozicionin tuaj në treg.

- Përshkruani shkurtimisht sasinë e peshkut që do të prodhoni/peshkuar, vëllimin ekzistues të shitjeve dhe çmimet mesatare të marra.

1.2 Lloji i shoqërisë tregtare.

- Shpjegoni dhe paraqisni një listë të shoqërive që kanë lidhje pronësie me aktivitetin/biznesin tuaj, të cilat janë të lidhura ngushtë me funksionimin e aktivitetit tuaj ekzistues nëse ka.

1.3 Përshkrimi i burimeve të financimit.

- Përshkruani dhe paraqisni garancitë financiare, që kanë lidhje me aktivitetin dhe që garantojnë zbatimin e detyrimeve të investimeve të marra përsipër.

1.4 Niveli i punësimit.

- Numri total i të punësuarve me kohë të plotë, si dhe numri i të punësuarve me kohë të pjesshme dhe sezonale.

- Përshkruani strukturën e drejtimit të biznesit.

1.5 Performanca e aktivitetit për tri vitet e fundit, si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë.

- Jepni përshkrime të nivelit të performancës financiare të kohëve të fundit si dhe deklaroni ose bashkëngjisni dokumentacion provues që aplikanti nuk ka detyrime për nergjine elektrike, organet tatimore.
- Operatori nuk duhet të jetë i denuar sipas nenit 45 pika 1 e ligjit nr. 9643 datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Përshkruani analizën e balanceve të 3 viteve të fundit Analizoni shkurtimisht informacionin e bilancit dhe pasqyrës së ardhurave dhe shpenzimeve për tri vitet e fundit,

2. PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT

2.1 Paraqitni me një përshkrim të shkurtër apo një panoramë të përgjithshme të investimit të ri, si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin. Përshkruani investimin ekzistues në Shqipëri i cili vihet në dispozicion të propozimit.

- Përshkruani shkurtimisht llojin e aktivitetit, procesin e prodhimit dhe rezultatet përfundimtare të pritshme aty ku është e mundur.

- Shpjegoni synimin përse dëshironi të ndërmerri këtë projekt.

2.2 Analiza e tregut të prodhimit peshkor.

Lutemi të merrni parasysh çështjet e mëposhtme nëse do të zhvillohet/paraqitet një produkt peshkor cilësor në bazë të investimit të ri:

- Përshkruani natyrën dhe përmasat e tregut për produktin peshkor dhe përcaktoni konsumatorët tuaj

kryesorë;

- Çmimet e produktit peshkor që do të peshkohet/prodhohet krahasuar me tregun;
- Përshkruani marrëveshjet e paraprahe me blerësit për prodhimin peshkor të peshkuar/prodhuar si rezultat i investimit, nëse ka; Përshkruani kontrata të ngjashme në fushën e peshkimit.
- Përshkruani konkurrentët tuaj kryesorë dhe se si keni ndërmend të konkurroni me ta.

2.3 A keni kontrata ekzistuese ose eksperiencë të ngjashme?

- Përshkruani shkurtimisht kontratat ekzistuese apo ato potenciale në lidhje me investimin tuaj, nëse ka.

2.4 Niveli i punësimit dhe aftësitë e nevojshme me grafikë të ndarë në vite.

- Shpjegoni cilat janë aftësitë e nevojshme për ta bërë këtë projekt (propozim) të suksesshëm dhe se si ju synoni t'i siguronit këto aftësi.

- Nëse synoni të punësoni staf të ri lutemi të përshkruani numrin, eksperiencën dhe kualifikimet që ata duhet të kenë për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës e specifikuar për çdo vit.

2.5 Legjislacioni i zbatueshëm për këtë investim.

- Rendisni legjislacionin që zbatohet për këtë aktivitet të zënies/prodhimit të peshkut dhe përshkruani hapat që ju duhet të ndërmerri për të siguruar që aktiviteti juaj të jetë i pajtueshëm me të.
- Evidentoni dhe përshkruani lejet/ licencat/certifikatat/ patentat etj., të nevojshme për zbatimin e investimit të ri dhe ushtrimin e aktivitetit.

2.6 Përshkrim i riskut të investimit.

- Identifikoni dhe përshkruani fushat kryesore të riskut brenda projektit tuaj dhe ndikimin që këto mund të kenë në suksesin e projektit të ri.
- Përshkruani çfarë do të bëni ju për të zbutur/minimizuar ndikimin e këtyre risqeve.

- Përshkruani ndikimet sociale të investimit të ri mbi aktivitetin tuaj dhe komunitetin e gjerë nëse ka.

3. PROJEKTI TEKNIK I INVESTIMIT TË PROPOZUAR

3.1 Teknologjia, procesi i prodhimit të propozuar dhe niveli i zënies/prodhimit të peshkut, kjo e lidhur/shprehur me efektivitetin në sasi peshku i peshkuar/prodhuar dhe i shitur.

- Përshkruani teknologjinë që do të futet në përdorim, kapacitetin e saj, si dhe arsyet për të cilat ky kapacitet është përzgjedhur në lidhje me lëndët e para që keni në dispozicion (rasate peshku, rrjeta peshkimi etj.).

- Përshkruani sasinë e peshkut që mund të peshkoni/prodhoni gjatë kryerjes së këtij investimi sipas viteve. Prodhimi duhet të jete për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

- Nëse aktiviteti i zënies/prodhimit të peshkut kërkon kohë për të arritur që të shfrytëzohen me kapacitet të plotë, kjo duhet të shpjegohet në mënyrë të qartë. Për shembull, në vitin 1 pas nënshkrimit të kontratës, kapaciteti i shfrytëzuar është ____%, në vitin 2 arrin në ____% dhe në vitin 3 ____% e me radhë deri kur arrin shfrytëzimin e plotë të kapacitetit. Ky përshkrim duhet të përgatitet për mjetet e veglat që përdoren për zënie/prodhimin e peshkut, pajisjet dhe punimet e ndërtimit që propozohen.

3.2 Ndërtimi/ rikonstruksioni nëse ka.

- Paraqisni një projektide të ndërtimit/ rikonstruksionit të planifikuar. Ndërtimet/ rikonstruksionet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e peshkimit/ akuakulturës dhe atë mjedisore si dhe të akteve të tjera ligjore në fushat perkatese.

- Në rast të investimit ekzistues përshkrim i gjendjes faktike të këtij investimi.

3.3 Pajisjet e nevojshme.

- Paraqisni një listë të mjeteve/ veglave e pajisjeve të nevojshme që iu duhen për zhvillimin e aktivitetit të zënies/ prodhimit të peshkut.

4. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTIT TË RI TË PROPOZUAR

4.1 Përmbledhje e kostove dhe financimit.

- Lutemi të paraqisni një përmbledhje të totalit të kostove të investimit të propozuar.

4.2 Komente për parashikimin e të ardhurave dhe fitimit.

- Në rastet kur një aktivitet i zënies/ prodhimit të peshkut ekzistues do të zhvillohet me pritmërinë se do të krijojë të ardhura shtesë, është e nevojshme të paraqitet informacion financiar për aktivitetin ekzistues përpara investimit dhe më pas të planifikohen flukset financiare pas investimit.

- Rezultatet e analizës së të ardhurave dhe analizës së shpenzimeve për investimin e aktivitetit të zënies/ prodhimit të peshkut për të cilin aplikoni për konkurrim publik, duhet të formojnë bazën për planifikimin e flukseve të reja të parave, që iu nevojiten për vazhdimësinë e këtij aktiviteti.

Aplikimi do të bëhet në portalin e-Albania: Aplikimi online për konkurrimin publik, vetëm me planin e biznesit të firmosur për çdo faqe.

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Njoftim për vend të lirë pune

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Inxhinierisë Informatike shpall **1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë, në kategorinë asistent-lektor në fushën e Inxhinierisë Informatike** që të mbulojë lëndët si më poshtë;

Në diplomat, Bachelor në Inxhinieri Informatike, FTI

- Rrjetat e kompjuterave;
- Strukturë të dhënash.

Në ciklin e dytë Master Profesional në Inxhinieri Informatike:

- Sisteme operative dhe rrjetat (laboratore dhe detyra).

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Informatike;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), e barabartë ose më e lartë se 9.00; për sistemin 3+2 Bachelor të jetë ≥ 8.5 dhe Master i Shkencave të jetë ≥ 9.00 ;
3. Të ketë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në nivelin C1. Preferohet gjuha angleze;
4. Të ketë artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proccedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë Informatike, si tregues për fushën e ardhshme kërkimore – shkencore të kandidatit;
5. Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në mësimdhënie në universitet;
6. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT ose i Fakultetit/Universitetit përkatës ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 14.05.2021 pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose “DOKTOR” të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
Njoftim për vend të lirë pune

Lënda: Dërgohen kriteret e punësimit për 1 (një) vend pune në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si edhe në Urdhrin Nr. 37, datë 27.04.2021 “Për miratimin e kriterëve për personel ndihmës akademik me karakter administrativ në Fakultetin e Mjekësisë Dentare Tiranë”, UMT-së, shpall konkursin për **1 (një) vende në pozicionin e punës, personel ndihmës akademik me karakter administrativ “Laborant”** si me poshtë:

Kandidatët për personel ndihmës akademik, me kohë të plotë, pozicioni “Laborante”, në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, pranë UMT-së, duhet të plotësojnë këto kriterë:

Kriterë

1. Të jetë shtetas shqipëtar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në profilin Stomatologji;
5. Të ketë njohuri në praktikat laboratorike me studentet dhe punë administrative;
6. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore (gjuha angleze përbën avantazh, Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht);
7. Të ketë njohuri në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve bazë (exel, word) të paketës Microsoft Office.
8. Të ketë aftësi të mira komunikuese, etik profesionale dhe të punës në grup;

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, pranë QSUT dosjen personale (të inventarizuar), me dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave;
5. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;
6. Kopje e noterizuar e dëshmisë së paketës Microsoft Office;
7. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
8. Formular vetdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
10. Referenca që provojnë vlerësimet pozitive;

11. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) të marrë brenda tre muajve të fundit;

Mungesa e një prej dokumentave të kërkuara më sipër, sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i kërkuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e Arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë pune me datën e shpalljes në Buletinin e APP-së.

A. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në Institucionet e Arsimit të Lartë.

B. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@umed.edu.al